



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:280276
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05492076

C.nr.1938/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses H.XH., nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, që të dy avokatë në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e V.Rr., me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 481.20 euro, jashtë seance me datë 22.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses H.XH., nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses të lartcekur, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për periudhën kohore nga 01.01.2020 e deri me datë 15.04.2021, të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 67.37.-€ (gjashtëdhjetë e shtatë euro e tridhjetë e shtatë cent) me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 19.12.2022 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit, në shumën prej 413.83.-€.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 228.00.-€ (dyqind e njëzet e tetë euro) në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja HH.XH., nga Gjakova, në këtë gjykatë me datë 19.12.2022, përmes të autorizuarve të saj Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, që të dy avokatë në Prishtinë, ka ushtruar padi kundër të

paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësja është punëtoare e arsimit në shkollën “...” në fshatin Në bazë të nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditëses. Në padi ka kërkuar nga gjykata që ta detyroi të paditurën që në emër të kompensimit të diferencës së inflacionit në pagë nga data 01.01.2018 deri me datë 30.09.2022 paditëses të ia paguajë shumën prej 481.20 euro, e ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj V.Rr., në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 28.09.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se ky kompensim paditëses nuk i takon as me kontratën e punës, e gjithashtu as me Ligjin e Punës. Sa i përket Kontratës Kolektive ka konsideruar se e njëjta është në kundërshtim me Ligjin e Punës, pasi që Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve. Tutje ka shtuar se paditëses nuk i takon e drejta e kompensimit të inflacionit pasi që në rast të shfaqjes së tij nuk godet vetëm një sektor të punësuarve si në rastin konkret sektorin e arsimit, por e godet tërë aparatit shtetëror. Ka konsideruar se në rastin konkret ka po ashtu parashkrim të kërkesës në të holla, andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “... në ., komuna e Gjakovës, si mësimdhënëse e mësimi klasor. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses për vitin 2021 ka qenë në shumën prej 421.00 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe

Sindikates së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga listat e pagave që gjenden në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjes zingjirore të inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen nga viti 2020 dhe për vitin 2021 (*brenda kërkesës së paditëses*) sipas përlllogaritjes si në vijim:

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditëses e cila në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 10.10 euro, apo 0.84 euro për muaj ($421.00 \cdot 0.2\% \cdot 12 = 10.10$).

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditëses e cila në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 4 mujore në total të jetë 57.26 euro, apo 14.31 euro për muaj ($421.00 \cdot 3.4\% \cdot 4 = 57.26$).

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data 01.01.2020 deri me datë 15.04.2021 në pagën e paditëses nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilëne pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Në procedurën kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse siç parashihet me nenin 2 të LPK-së.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe

Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës në tërësi, ky pretendim rezulton i pabazuar sa i përket periudhës prej datës 01.01.2020 e deri me datë 15.04.2021 pasi që konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 19.12.2022, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumës në lartësi prej 413.83 euro gjykata të njëjtën e refuzoi për shkak se paditësja as me padi, as në precizimin e padisë nuk ka prezantuar prova materiale për të vërtetuar këtë lartësi të kërkesës, sipas detyrimit të përcaktuar me nenin 7 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. E për më tepër, gjykata përlllogaritjen e përfshirjes së inflacionit në pagën bazë e ka filluar nga viti 2020, duke shtuar normën e inflacionit deri në vitin 2021, për çka rezultoi se pjesa e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar është e pabazuar, andaj gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilën refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Po ashtu pjesa refuzuese i referohet edhe kërkesës së paditëses që të i kompensohet pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit edhe për periudhën prej 01.05.2021 deri më 30.09.2022 pasi që nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht kontrata e punës për paditësen rezulton se e njëjta ka lindur me datë 15.04.1956, e që i bie se moshën 65 vjeçare pra atë të pensionimit e ka arritur me datë 15.04.2021, për çka edhe gjykata nuk ia njohi këtë kompensim paditëses për periudhën e lartcekur.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit, gjykata e morri sipas nenit 449 dhe 452 të LPK-së, duke pasur parasysh suksesin në procedurë, me ç’rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 228.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve

për pagesën e taksës gjyqësorë në vlerë prej 20.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17), si dhe për përpilimin e parashtrësës për plotësimin e padisë shumë prej 104.00.-€.

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
-Departamenti i Përgjithshëm-
C.nr.1938/22, datë 22.03.2024

Gj y q t a r j a,
Fëllanza Knushaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.